



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja Nr. 29  
Prishtinë, më 8.07.2009  
Salla N-225 ora 10,00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Hestet Cakolli, Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq

**Mungon:** Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i UNDP-së, OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi **Agim Veliu**, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

**Agim Veliu** -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.**

**Kryetari i Komisionit**- konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 17.06.2009 dhe 24.06.2009.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë.**

**Agim Veliu** -kryetar, lidhur me ecurinë e punës të shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, hapi debat lidhur me këtë pikë.

**Gani Buçinca**- propozoi që Komisioni më parë të shqyrtoi dhe analizoi vetëm vërejtjet dhe sugjerimet e këtij Projektligji të marra nga Dëgjimi publik të përfaqësuesve të të rinjve dhe përfaqësuesve të grupeve të interesit, ndërsa të gjitha materialet e përgatitura në formë të shkruar të shqyrtohen në mbledhjen e radhës. Ai nuk u pajtua lidhur me çështjen e ngritur nga grupi joformal i të rinjve që puna vullnetare e të rinjve të njihet si përvojë pune, nga se kjo do të ketë implikime buxhetore.

**Drita Kadriu** – në mungesë të materialit i përgatitur nga raportuesi i Projektligjit, propozoi që Komisioni më parë të shqyrtoi vërejtjet e dala nga Dëgjimi publik dhe në bazë të metodologjisë së punës të amendamentojë Projektligjin nen për nen.

**Enis Kervan** përkrah mendimin e parafolësit por propozoi që raportuesi i këtij Projektligji të bëjë leximin nen për nen dhe më pas Komisioni gjatë shqyrtimit të Projektligjit të ofrojë propozimet e veta.

**Donika Kadaj - Bujupi** tha se është caktuar raportuesi që ti përmbledh të gjitha sugjerimet dhe rekomandimet dhe para Komisionit të paraqitet me propozime konkrete. Më pas propozoi që Komisioni të fillojë procedurën e amendamentimit të Projektligjit.

**Adem Hajdaraj** – mendon se Komisioni, në bazë të praktikës së punës të filloi shqyrtimin e Projektligjit nen për nen dhe gjatë amendamentimit të tij do ti shqyrtoj edhe propozimet e marra nga Dëgjimi publik.

**Kryetari i Komisionit** - konstatoi se Komisioni do ti shqyrtoi konkluzionet e dala nga Dëgjimi publik në Projektligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, nga përfaqësuesit e organizatave rinore në nivel qendror dhe lokal, përfaqësuesit e Ministrisë përkatëse dhe organizatave ndërkombëtare që e mbështesin sektorin e rinisë të Kosovës dhe do të procedojë amendamentimin e Projektligjit nen për nen.

Lidhur për këtë projektligj fjalën ia dha raportuesit Arsim Rexhepi

**Arsim Rexhepi** – referuesi i Komisionit tha se Projektligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë është i rëndësishëm së veçantë me që të rinjtë në Kosovë përfaqësojnë pjesën dërmuese të popullsisë. Ky Projektligj ka për qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme sociale, arsimore, materiale, politike në përputhje me standardet evropiane. Arsim Rexhepi tha se së bashku me stafin mbështesë të komisionit kemi përgatitë një dokument me propozime të cilin material me kohe iu është shpërndarë anëtarëve të Komisionit.

Njëkohësisht Komisioni gjatë amendamentimit të projektligjit do ti shqyrtojë vërejtjet dhe propozimet e marra nga Dëgjimit publik nga përfaqësuesit e organizatave rinore dhe përfaqësuesit e rrjetit rinor të Kosovës.

## **Amendamenti 1**

**Neni 2.1** riformulohet: **“Përgjegjësitë themelore për fuqizimin e sektorit rinor në Kosovë dhe përkrahjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje”.**

## **Amendamenti 2**

**Neni 3, Përkufizimet** riformulohen si vijon:

**Neni 3.1.** riformulohet: **“Moshë rinore” ose “i ri, e re” - është grup-mosha e të rinjve prej 15 deri 24 vjeç.**

**Neni 3.2.** në reshtin e parë fjala “nënkupton një” zëvendësohet me fjalën “është”.

**3.2. “Organizatë rinore” - është** organizata jofitimprurëse, e themeluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku shumica e anëtarëve janë të rinj.

**Neni 3.3. Të harmonizohet në tri gjuhë “Ministria” - nënkupton** Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit.

**Neni 3.4. riformulohet: “Qendër rinore” është hapësira e funksionalizuar për zhvillimin e veprimit të të rinjve e licencuar nga drejtoria komunale përgjegjëse për rini.**

**Neni 3.5.** në rreshtin e parë fshihen fjalët **“nënkupton atë segment të shoqërisë që”** vazhdon teksti.

**3.5 “Sektor i rinisë” - përfshin të gjitha** organizatat qeveritare, joqeveritare, publike dhe private si dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë të angazhuar në programe për të mirën dhe realizimin e interesave të të rinjve.

**Neni 3.6** në reshtin e parë fjala “nënkupton” zëvendësohet me fjalën “është”.

**3.6 “Program rinor” - është** programi që adreson nevojat e të rinjve, në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, të miratuar dhe të mbikëqyrur drejtpërdrejt nga drejtoria komunale përgjegjëse për rini, nëse përfshin vetëm një komunë dhe nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Ministrisë, përkatësisht të Departamentit të Rinisë si përgjegjës për rini, nëse përfshin më shumë se një komunë.

**Neni 3.7** riformulohet: **“Drejtori komunale e rinisë” - është drejtoria komunale të kulturës, të rinisë dhe të sporteve.**

**Neni 3.8,** riformulohet. **“Këshilli i veprimit të rinisë” – është organ** i përfaqësimit rinor i përbërë nga përfaqësuesit e organizatave rinore jofitimprurëse të nivelit qendror dhe lokal.

**Neni 3.9.** riformulohet: **“Punë vullnetare e rinisë” – është një veprimtari e rinisë e organizuar nga Institucioni përkatës,** ku të rinjtë vullnetarisht ofrojnë kohën, punën,

njohuritë, aftësitë e tyre pa pagesë apo shpërblim, në shërbim të komunitetit, për të mirën e shoqërisë. Puna vullnetare e rinisë do të njihet si përvojë pune **nga Drejtoria Komunale për Kulturë përkatësisht Ministria. Dëshminë për këtë e lëshon Institucioni përkatës.**

**Neni 3.10.** riformulohet: **”Edukimi joformal” – është** veprimtaria mësimore e realizuar gjatë tërë jetës, me qëllim të përmirësimit të njohurive, të shkathtësive dhe të kompetencës, në kuadër të perspektivës individuale, qytetare, shoqërore që lidhet me punësimin.

## **Amendamenti 3**

**Neni 5. “Përgjegjësitë e të rinjve”.**

Pikët në vazhdim fshihen dhe riformulohen si vijon:

**5.1. Të rinjtë, respektojnë parimet e paqes, të drejtësisë dhe të mirëkuptimit ndërmjet njerëzve që kanë për qëllim mirëqenien dhe zhvillimin në Republikën e Kosovës.**

**5.2. Të rinjtë, respektojnë barazinë dhe dinjitetin e të gjithë njerëzve, të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.**

## **Amendamenti 4**

**Neni 6. 1** në rreshtin e par shihet fjala “pas këshillimit” zëvendësohet me **“në pajtim “** dhe në rreshtin e fundit fshihet fjala **“sidomos”**.

**6.1.** Organet e pushtetit qendror, **në pajtim** me Këshillin e veprimit të rinisë të Kosovës, mbajnë përgjegjësi:

## **Amendamenti 5**

**Neni 12, pika 1,** në rreshtin e katërt pas fjalës ‘ të rinjë’ fshihet teksti.

**12.1. “Qendrat rinore ofrojnë hapësirë për programet dhe veprimtaritë e të rinjve në bazë të statutit të tyre, ndërsa janë të hapura për të gjithë të rinjtë”.**

**Neni 12, pika 3,** fshihet fjala “pas këshillimit” zëvendësohet me **“në pajtim”**.

**12.3.** MKRS-ja, me vendim të veçantë, **në pajtim’** me Këshillin e veprimit të rinisë, do të përcaktojë udhëzimin për licencimin e një qendre rinore.

## **Amendamenti 6**

**Neni 13. 2.** pas paragrafit **2.6** shtohet **paragraf i ri.**

**2.7. “Ambient, planifikim hapësinor dhe zhvillim rural”.**

**Vërejtje teknike.**

Para titullit “**Dispozitat kalimtare**” të shkruhet “**Neni 19**”.

**Neni 19**  
**Dispozitat kalimtare**

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji do të nxirren jo më vonë se gjashtë muaj, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Kryetari i Komisionit** – *konstatoi se mbledhja e ardhshme e Komisionit do të mbahet me 14.07.2009 në ora 11.00 ku do të shqyrtohen amendamentet e propozuara për këtë Projektligj.*

*Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 13,10.*

***Kryetar i Komisionit,***  
***Agim Veliu***